

**VENDIM**  
**Nr.278, datë 18.3.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS TREBINJË, TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Trebinjë, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Trebinjë të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.35, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Trebinjë, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Trebinjë për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**  
Lidhja nr.1

Komuna Trebinjë

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                                                                          | <b>Lloji i transferimit</b> |
|---------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 3-17 (vetëm trojet)                                     | Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.                                 | Në përdorim                 |
| 3-17 (vetëm sheshet)                                    | Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike).                                                                      | Në pronësi                  |
| 18-46                                                   | Varresat publike.                                                                                                            | Në pronësi                  |
| 47-62                                                   | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.                                                 | Në pronësi                  |
| 63-68                                                   | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.                                                          | Në pronësi                  |
| 69-83                                                   | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                                                                      | Në pronësi                  |
| 493-510                                                 | Infrastrukturë (rrugë vendore).                                                                                              | Në pronësi                  |
| 511-544                                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).                       | Në përdorim                 |
| 545-569                                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi                  |
| 589-603                                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.                                           | Në pronësi                  |